

REZYME PANAIRI I EDUKIMIT 2016

Përmbledhje dhe informata nga Edicioni i 10 të i Panairit të Edukimit 21-22 prill 2016

Ekspozuesit e Panairit
Visitorët e Panairit
Statistikat
Video Dokumentari
Foto Galeria
Mediat mbi Panairin

www.ceokos.com



Congress & Event Organization



EDUCATION FAIR

Përmledhje

Kompania Congress & Event Organization hapi me sukses edicionin e 10-të me radhë të panairit ndërkombëtar të EDUKIMIT, i cili u mbajti në datat 21-22 prill 2016 në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë.

Ky aktivitet që njëkohësisht është ngjarja e vetme promovuese e fushës së edukimit në vend edhe këtë vit kishte përkrahjen e dy institucioneve shumë të rëndësishme, atë të drejtorisë së Arsimit nga Komuna e Prishtinës dhe atë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës

Vlen të përmendet edhe bashkëpunimi me Agjencinë për arsim dhe aftësim profesional dhe arsim për të rritur, e cila mori iniciativën dhe mbeshteti të gjitha qendrat e kompetencës në Kosovë që të ishin ekspozues në panair të edukimit.

Gjatë dy ditëve të ekspozimit, panairi arriti të tërheqë rreth vetës numër të madh të ekspozuesve nga të gjitha fushat e institucioneve arsimore si: shkolla të arsimit fillor dhe të mesëm. Në këtë panair ishin pjesëmarrëse të gjitha shkollat e mesme profesionalenga komuna e Prishtinës, të gjitha shkollat e kompetencës nga i tërë territori i Kosovës, institucione të arsimit të lartë si kolegje dhe universitete të ndryshme, qendra trajnuese, kurse të gjuhëve, institucione për ofrimin e bursave, institucione të punësimit dhe asociacione tjera edukative vendore dhe të huaja.

Një pjesëmarrje e tillë ka tërhequr kështu vëmendjen e një numri të madh të nxënësve, studentëve, prindërve dhe të gjithë faktorëve tjerë vendimmarrës që morën pjesë si vizitorë, e që ishin nga i gjithë territori i Kosovës dhe më gjerë.

Hapja e panairit u bë nga Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Arsim Bajrami dhe nga drejtoresha e arsimit në drejtorinë e Komunës së Prishtinës, znj. Arbërie Nagavci.



Me këtë rast, Ministri Bajrami, tha se ky Panair i Edukimit, ofron mundësi të mirë edhe të këmbimit të produkteve dhe përvojave të nxënësve dhe shkollave.

Gjithashtu ai u shprehu se kjo është një mundësi e mirë që të promovohen mundësitë që ka sfera e edukimit, sidomos e arsimit profesional, në mënyrë që të shohim shkathtësitë dhe inovacionin e nxënësve tanë.

“Jemi të angazhuar që përmes edukimit të krijojmë një rini të edukuar dhe arsimuar, me kompetenca dhe shkathtësi, që nesër do të bëhet edhe bartëse e proceseve të tranzicionit, kjo edhe për faktin se kemi një rini inteligjente, e cila meriton të ketë edukim dhe aftësim profesional të nivelit evropian”, tha ministri Bajrami.

Në vazhdim, ministri shtoi se MASHT është duke bërë një rishikim strategjik të programeve edukativo-arsimore, sipas nevojave të tregut të punës.

Ndërsa drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit, znj. Arbërie Nagavci në hapjen e këtij panairi në fjalën e saj të rastit theksoi se “Komuna e Prishtinës në vazhdimësi është duke mbështetur shkollat e mesme profesionale në ngritje të cilësisë dhe duke krijuar kushte për një mësimdhënie dhe mësim-nxënie cilësore. Interesimi i nxënësve për regjistrim në shkolla profesionale ka shënuar një kthesë pozitive, ku nga viti i kaluar kërkesa për regjistrim e nxënësve është me suksese dhe rezultatet të larta.



Në panair janë pjesëmarrëse shtatë shkollat profesionale të Komunes së Prishtinës ku gjatë këtyre dy ditëve këto shkolla profesionale do të vizitohen edhe nga shkollat fillore të klasave të nënta për të shikuar nga afër punët që kryhen në këto shkolla”.

Vlenë të theksohet se ky është viti i tretë që Panairi i Edukimit ka një bashkepunim jashtëzakonisht të mirë me drejtorinë e arsimit në Komunë të Prishtinës. Ky bashkepunim ka pas për qëllim nxitjen dhe ngritjen e vetëdijes së nxënësve duke i njoftuar mbi mundësitë e ndryshme për shkollim të metutjeshem.

TË DHËNA MBI PANAIRIN “EDUCATION FAIR 2016”

Hapja zyrtare: 21 prill 2016, ora: 10:00

Vendi: Pallati i Rinisë në Prishtinë

Origjina e ekspozuesve: Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Austri, Finland, Gjermani, Angli, Austali, USA, Turqi etj.

Numri i përgjithshëm i vizitorëve: 13.683


Profili i vizitorëve: nxënës, student, prindër, mësues, udhëheqës të institucione të ndryshme edukativo arsimore etj.

Mbyllja zyrtare: 22 prill 2016 ora: 18:00

Video dokumentari: – [EDUCATION FAIR 2016](#)


Foto Galeria: [Education Fair 2016](#)






STATISTIKAT

Mosha e vizitoreve
Age of visitors




- 5-10 vjec / years - 0%
- 15 - 20 vjec / years - 39%
- 20 - 25 vjec / years - 42%
- 25 - 30 vjec / years - 9%
- 30 - 35 vjec - 5%
- mbi/over 35 vjec / years - 5%

Statusi / Status




- Nxenesë / Pupil 42%
- Studente / students 44%
- Prindër / Parents 3%
- Tjeter / Other 11%

Të interesuar për
Interested In




- Kurse / Courses - 12%
- Trajnime / Trainings - 22%
- Gjinnaze / Gymnasium - 4%
- Shkolla Profesionale / Professional Schools - 4%
- Universitete Publike / Public Universities - 15%
- Universitete Private / Private Universities - 9%
- Bachelor - 14%
- Master - 19%
- PhD - 1%


Fakultetet që kanë interes të Studiojmë
Faculties who they are interested to study



Shtetet ku studentet kanë interes të studiojnë
States where students have interest to study



Origjina e vizitoreve
Origin of visitors



PANAIRI “EDUCATION FAIR” NE MEDIA

Panairi u përcoll nga një numër i madh mediesh të shkruara dhe elektronike nga vendi dhe rajoni, si: RTK, RTV21, KTV, TV Klan Kosova, TOP Channel, TV Dukagjini, Rrokum TV, Radio Kosova, Radio Dukagjini, Radio Blue Sky, Radio 21, Radio Alba, Radio Plus, Radio Besa, Radio Tring, Koha Ditore, Kosova Sot, Bota Sot, Zëri, Epoka e Re, Tribuna, Kosova Press, Telegrafi, Kosova Info, Indeksonline, Kosova Live, Agjencia Ekonomia, Kosova Haber, TRT Albanian, Ekonomisti, Info Globi, Alb Info, Poslovni Dnevnik, Lajme shqip, Kosova In, Toskana Press, Shtypi i Ditës, Paragrafi, Monitor, Profit, Qendra Info, Info Ditore, Kosova Times, Lexo shqip, Gazeta Ditore, UrbanMag, etj.